



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

V E N D I M

PËR KTHIMIN PËR PLOTËSIM TË LISTËS SHUMEMËRORE TË KANDIDATËVE PËR ANËTARË NË KËSHILLIN E BASHKISË VLORË, TË DEPOZITUARA NGA PARTIA "G-99" PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 30 QERSHOR 2019

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 16.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për kthim për plotësim të listës shumëmemërore të kandidatëve për anëtar në Këshillin e Bashkisë Vlorë, të paraqitura nga Partia "G-99", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

BAZË LIGJORE: Neni 23, pika 1, gërma a, neni 67, neni 72 dhe neni 73, pika 1, të Ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë"

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Partia "G-99", si dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

V Ë R E N:

Partia "G-99", është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

Në bazë të nenit 67 dhe nenit 72, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, Partia "G-99" ka paraqitur në KQZ dokumentacionin për miratimin e listave shumëmemërore.



Nr. 431 i Vendimit

Data 16.05.2019

Ora 18:00 e Vendimit

Për kthimin për plotësim të listës shumëmemërore të Partisë "G-99", zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019

Në mbledhjen e datës 16.05.2019 në bazë të nenit 73, të Kodit Zgjedhor, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve verifikoi listat shumëmemërore të kandidatëve për anëtarë të këshillit bashkiak të Partisë "G-99" dhe dokumentacionin bashkëngjitur të paraqitur dhe konstatoi mangësitë e dokumentacionit si më poshtë:

1. Numri i kandidatëve është më i vogël se gjysma e numrit të mandateve në këshillin bashkiak nga 26 ka depozituar 7;
2. Nuk është respektuar kuota gjinore në listën shumëmemërore Model 10 K;
3. Deklarimi për vendet sipas kuotës gjinore Modeli 09 K;
4. Dokumenti identifikimit dhe deklarata të kandidatëve për anëtarë të këshillit bashkiak.

Në këto kushte KQZ duhet:

Të kthej për plotësim dokumentacionin e kandidimit, për korrigjimin e mangësive të konstatuara, nga "Partia G99".

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mbështetur në nenin 23, pika 1, gërma a, nenin 67, pikat 1, 4, 5, dhe 6, nenin 72, dhe nenin 73, pika 1 të Ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

V E N D O S I:

1. Kthimin për plotësim të dokumentacionit për regjistrimin e listës shumëmemërore të kandidatëve për anëtarë Këshilli të Bashkisë Vlorë, të Partisë "G-99", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare



Nr. 431 i Vendimit

Data 16.05.2019

Ora 18:00 e Vendimit

Për kthimin për plotësim të listës shumëmemërore të Partisë "G-99", zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019